

VENDIM
Nr. 910, datë 22.12.2014

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR KFOR, KOSOVË

(Ndryshuar me VKM nr. 726, datë 8.12.2017; nr. 820, datë 18.12.2019; nr. 163, datë 20.03.2024; nr. 471, datë 26.6.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen në operacionin ushtarak ndërkombëtar KFOR, Kosovë, të 12 (dymbëdhjetë) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Misioni është planizimi, monitorimi, komandimi dhe kontrolli i aktivitetit operacional të seksioneve dhe njësive të KFOR-it.

3. Venddislokimi të jetë në bazën e Shtabit të KFOR-it, në Prishtinë, Kosovë.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2027. Periudha e qëndrimit në mision, për çdo përfaqësues, të jetë me sistem rotacioni deri në 6 (gjashtë) muaj dhe 1 (një) vit për postin ACOS SPT, periudha, të cilave u shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrje dhe dorëzim detyre, vonesa të transportit strategjik).

5. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerje disipline;

ë) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit që do të shërbejë në Kosovë, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t’u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanteria, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve ku do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, ku pala tjetër të marrë përsipër të përballojë këto shpenzime.

7. Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Tiranë-Prishtinë dhe anasjelltas, është përgjegjësi e palës shqiptare.

8. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

9. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

10. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama